KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Nëntor 2023

08.12.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin nëntor 2023, viti bazë 2015=100.

Çmimet e konsumit shkuan në 2,9% vjetore dhe -0,1% mujore

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 2,9% në muajin nëntor 2023, krahasuar me muajin nëntor 2022. Inflacioni mujor ishte (-0,1%) në muajin nëntor 2023.

Norma mujore dhe vjetore e inflacionit në %



Nëntor 2023 / Nëntor 2022 2,9 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej (2,9 %) në muajin Nëntor 2023 krahasuar me muajin Nëntor 2022.

Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pemët (19,4%), perimet (16,1%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (10,8 %), sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat (7,7%), prodhimet ushqimore (7,0%), veshjet dhe këpucë (6,0%), pijet alkoolike, duhani (5,9%), rekreacionet dhe kultura (5,3%), energjia elektrike, gaz dhe lendet djegëse të tjera (4,8%), buka dhe

drithërat (3,5%), mallrat dhe shërbimet e ndryshme (2,7%) dhe mishi (1,2%), dhe me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 3,1 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: vajrat dhe yndyrat (-10,3%) dhe lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj (-4,9%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,2 për qind në IHÇK-it.

Nëntor 2023 / Tetor 2023 - 0,1 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit pësoi rënie në një mesatare prej (-0,1 %) në muajin Nëntor 2023 krahasuar me muajin Tetor 2023. Kjo kryesisht është shpjeguar me rënien e çmimeve të konsumit te nëngrupet e COICOP-it: shërbimet për transport (-4,0%) dhe karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-3,6%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,4 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa ngritja e çmimeve vërehet te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: energjia elektrike, gaz dhe lendet djegëse të tjera (2,9 %), qumështi, djathi dhe vezët (0,8 %) dhe ushqimi dhe pijet joalkoolike (0,2%), dhe me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,3 për qind në IHÇK-it.

Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it, Kosovë

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2023 në ‰	XI - 2023 2015=100	XI - 2023 / X - 2023	XI - 2023 / XI- 2022
00	Gjithsej IHÇK	1000.0	129.4	-0.1	2.9
01	Ushqimi dhe pijet joalkoolike	381.9	142.6	0.2	3.5
02	Pijet alkoolike, duhani	64.4	137.0	-0.1	5.9
03	Veshje dhe këpucë	41.1	107.6	-0.3	6.0
04	Strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	89.4	123.9	2.1	4.0
05	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	62.0	120.6	0.4	5.0
06	Shëndetësia	24.1	116.7	0.0	3.6
07	Transporti	182.9	124.2	-2.1	-1.6
08	Mjetet e komunikimit	21.9	114.5	0.0	-0.5
09	Rekracioni dhe kultura	36.6	106.2	0.3	5.3
10	Arsimi	5.9	104.0	0.0	1.5
11	Restorantet dhe hotelet	32.1	129.3	0.0	4.0
12	Mallrat dhe shërbimet e ndryshme	57.8	118.3	0.0	2.7

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin nëntor 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation